

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

Nr. 14-451/01-137294 Më 09 SEP 2025

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr. 03/ L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15 qershor 2008), dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit merr këtë:

V E N D I M

I. Miratohet Vendimi për subvencionimin e prindërve të cilët kanë të regjistruar fëmijët e tyre në çerdhet me bazë në komunitet, në Komunën e Prishtinës.

II. Subvencionimi i prindërve/kujdestarëve ligjorë sipas pikës I të këtij vendimi do të bëhet në bazë të të ardhurave mujore neto si në vijim:

1. Prindërit/ kujdestarët ligjorë me të ardhura mujore neto deri në 700 €, subvencionohen në vlerë prej 50 €;
2. Prindërit/ kujdestarët ligjorë me të ardhura mujore neto deri në 900 €, subvencionohen në vlerë prej 30 €;
3. Prindërit/ kujdestarët ligjorë me të ardhura mujore neto deri në 1,100 €, subvencionohen në vlerë prej 20 €;
4. Prindërit/ kujdestarët ligjorë të fëmijëve me nevoja të veçanta, fëmijët bonjak (pa të dy prindërit), familjet me asistencë sociale, veteranët e luftës si dhe nënat vetushqyese do të subvencionohen në vlerë prej 70 €.

III. Prindërit/ kujdestarët ligjorë të cilët kanë të regjistruar biznese funksionale diskualifikohen nga subvencionohet si në pikën II.

IV. Për të përfituar nga subvencionimi i kategorizuar në pikën 1, 2, 3, të këtij Vendimi prindi/ kujdestari ligjorë duhet të dorëzoj vërtetim nga Trustit, ARBK dhe vërtetimin nga Enti për Punësim.

V. Për të përfituar nga subvencionimi kategorizuar në pikën 4 të këtij Vendimi, prindi/kujdestari ligjorë duhet të dorëzoj dëshminë përkatëse.

VI. Nëse prindërit nuk i raportojnë të dhënat e sakta mbi të hyrat, përjashtohen nga përfitimi i subvencionit në momentin e vërtetimit.

VII. Vlerësimi i kërkesave dhe vendimmarrja për subvencionim si në pikën II, do të bëhet nga një anëtar i caktuar nga komuna e Prishtinës dhe dy anëtarë të caktuar nga çerdhja.

VIII. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria për Financa e Komunës së Prishtinës.

IX. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi i datës 23.11.2018.

X. Ky vendim hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- Çerdheve me Bazë në Komunitet;
- Drejtorisë së Arsimit;
- Drejtorisë për Financa;
- Qendrës për shërbime me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT

Përparim Rama

